

Në bazë të nenit 18 paragrafi (1) nënparagrafi 3 dhe neni 20 paragrafi (1) nënparagrafi 10¹ të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 184/13, 13/14, 44/14, 101/14, 132/14, 142/16, 132/17, 168/18, 248/18 dhe 27/19 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr.42/20 dhe 77/21), dhe në lidhje me nenin 41 paragrafi (6) nga Ligji i njëjtë, neni 15 paragrafi (1) nënparagrafi 3 dhe neni 39 paragrafi (1) nënparagrafi 10 i Rregullores për punë të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale (Tekst i pastruar) ark.nr.01-3732/1 datë 29.7.2019, duke vepruar sipas Njoftimit për ndryshim të strukturës së pronësisë të Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive URBAN FM RADIO SHPKNJP Shkup nr.20-0302/13 datë 11.4.2023 (PA1 nr.02-161, datë 11.4.2023), në pajtim me Konkluzionin e Këshillit ark.nr. 02-1946/5 datë 4.5. 2023, Këshilli i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, në seancën e 14-të mbajtur më 3.5.2023, miratoi sa vijon:

VENDIM

1. LEJOHET ndryshim në strukturën e pronësisë të Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive URBAN FM RADIO SHPKNJP Shkup, përkatësisht:

- për largim të personit fizik [REDAKTUAR], me NVAQ [REDAKTUAR] dhe adresë në rrugën." [REDAKTUAR] nr. [REDAKTUAR], [REDAKTUAR] dhe

- për aderim të personit fizik [REDAKTUAR], me NVAQ [REDAKTUAR] dhe adresë në rrugën." [REDAKTUAR] nr. [REDAKTUAR], [REDAKTUAR].

2. Detyrohet Shoqëria Tregtare Radiodifuzive URBAN FM RADIO SHPKNJP Shkup, sipas ndryshimit të kryer në pikën 1 të këtij Vendimi, t'i dorëzojë Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale gjendjen aktuale vijuese e dhënë nga Regjistri Qendror i Republikës së Maqedonisë së Veriut.

3. Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit.

Arsyetim

Shoqëria Tregtare Radiodifuzive (SHTR) URBAN FM RADIO SHPKNJP Shkup, në pajtim me nenin 41 paragrafi (1) të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale (LSHMAAV) dhe Rregulloren për formën dhe përmbajtjen e njoftimit për ndryshimin e strukturës së pronësisë ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr.171/14), me Njoftim për ndryshimin e strukturës së pronësisë nr. 20-0302/13 të datës 11.4.2023. (PA1 nr. 02-161 datë 11.4.2023), e njoftoi Agjencinë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale (Agjencia) për qëllimin e tij për zbatim të ndryshimit të strukturës së pronësisë të SHTR URBAN FM RADIO SHPKNJP Shkup.

Njoftimi i dorëzuar për ndryshimin e strukturës së pronësisë nr.20-0302/13 datë 4.11.2023. (PA1 nr. 02-161 datë 11.4.2023), nga SHTR URBAN FM RADIO SHPKNJP Shkup, është konstatuar se është i plotë dhe i rregullt, respektivisht i përmban të gjitha të dhënat dhe dokumentet e përcaktuara në Rregulloren për formën dhe përmbajtjen e njoftimit për ndryshim të strukturës së pronësisë.

Agjencia, për të hetuar nëse ndryshimet e propozuara në strukturën e pronësisë të SHTR URBAN FM RADIO SHPKNJP Shkup do të krijojnë koncentrim të paligjshëm mediatik, respektivisht nëse bien në kundërshtim me ndalesat e neneve 34, 35 paragrafi (2) ose 38 të LSHMAAV, nëpërmjet Sistemit të shpërndarjes së internetit të Regjistrimit Qendror të Republikës së Maqedonisë së Veriut (RMV) ofroi "Informacion për subjektet që ndërlihet (personat e autorizuar, organet drejtuese, pronarë në subjekte të tjera) – gjendja aktuale", nr.0820-50/150020230099181 datë 12.4.2023, nga e cila rezulton se personi [REDAKTUAR] figuron si:

-Pronar, drejtues dhe person i autorizuar në filialin e Shoqërisë Tregtare për Prodhim, Qarkullim dhe Shërbime SOLOPROM SHPK Shkup, me veprimtari prioritare / kodi kryesor i të ardhurave është 46.76 – Tregti me shumicë me produkte gjysëm të gatshme (ky person juridik nuk paraqitet si themelues i Shoqërive Tregtare);

-partner në 1) Shoqërinë për Tregti dhe Shërbime RESTORANT ZING SHPK Shkupi, me veprimtari prioritare / kodi kryesor i të ardhurave është 56.10 – Restorante dhe objekte të tjera për përgatitjen dhe shërbim të ushqimit (ky person juridik nuk paraqitet si themelues i Shoqërive Tregtare), 2) Shoqëria për

¹Paragrafët 8 dhe 9 janë fshirë, shih: Nenin 8 të Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 248/18).

edukim interneti BREINSTER CBC KOLEKTIV SHPK Shkup, me veprimtari prioritare / kodi kryesor i të ardhurave është 85,59 – Arsimime të tjera, i papërmendur në vend tjetër. Ky person juridik është pronar i Institucioni të lartë arsimor i pavarur, shkollë e lartë profesionale BREINSTER NEKST Shkup, veprimtari me prioritare / kodi kryesor i të ardhurave është 85.42 – Arsim i lartë (ky person juridik nuk paraqitet si themelues i Shoqërive Tregtare), 3) Shoqëria për Prodhim dhe Tregti MULTIPRAKTIK SHPK eksport – import Manastir, me veprimtari prioritare / kodi kryesor i të ardhurave është 13.92 – Prodhim i produkteve të gatshme tekstile, përveç veshje (ky person juridik nuk paraqitet si themelues i Shoqërive Tregtare) dhe 4) Shoqëria për prodhim , tregti dhe shërbime JANIKA NATYRE SHPK Shkup, i cili veprimtari prioritare / kodi kryesor i të ardhurave është 64.20 – Veprimtari të holding-Shoqërive (ky person juridik nuk paraqitet si themelues i Shoqërive Tregtare);

-si pronar dhe prokuror i Shoqërisë për Tregti MINISO SOLO SHPK Shkup, me veprimtari prioritare/kodi kryesor i të ardhurave është 47.19 – Tregti me pakicë në dyqane të paspecializuara (ky person juridik nuk paraqitet si themelues i Shoqërive Tregtare).

Po ashtu, Agjencia ka kontrolluar edhe Regjistrin e pronarëve përfitues, i cili udhëhiqet nga Regjistri Qendror i RMV-së, nga ku siguroi dokumentin “Statusi aktual i personit fizik – pronar përfitues”, nr.2007-50/150020230099295 datë 12.4.2023, nga ku figuron se personi fizik paraqitet si pronar përfitues (i vetëm) i subjekteve juridike në vijim: ██████████ Shoqëria Tregtare për Prodhim, Qarkullim dhe Shërbime SOLOPROM SHPK Shkup; Shoqëri për Tregti dhe Shërbime RESTORAN ZING SHPK Shkup; dhe Shoqëria për Tregti MINISO SOLO SHPK Shkupi .

Pas ndryshimit të strukturës së pronësisë, pronar i vetëm i SHTR URBAN FM RADIO SHPKNJP Shkup do të jetë personi fizik ██████████, me numër NVAQ ██████████ dhe adresë në rrugën ██████████ nr. ██████, ██████.

Duke pasur parasysh se Agjencia ka konstatuar se zbatimi i ndryshimit të strukturës së pronësisë të SHTR URBAN FM RADIO SHPKNJP Shkup nuk krijon koncentrim të paligjshëm mediatik në kuptimin e LSHMAAV-së, gjegjësisht se ky ndryshim nuk bie në kundërshtim me ndalesat e neneve 34, 35. paragrafi (2) dhe 38 nga Ligji i njëjtë, pas Njoftimit të dorëzuar për ndryshim të strukturës së pronësisë nr.20-0302/13, datë 11.4.2023. (PA1 nr. 02-161, datë 11.4.2023), Këshilli i Agjencisë, miratoi vendim si në dispozitiv.

Nr 02-161

4.5.2023
Shkup

Agjencia për Shërbime Mediatike
Audio dhe Audiovizuale
Kryetari i Këshillit,
Lazo PETRUSHEVSKI, d.v.

Këshillë juridike : Kundër këtij vendimi transmetuesi, nëse nuk pajtohet me të, ka të drejtë në afat prej 30 ditësh nga dita e dorëzimit të vendimit, të paraqesë padi për ngritje të kontestit administrativ në gjykatën kompetente .